



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2345/ 4 prot.

Datë 22.11.2022

V E N D I M
Nr. 1129/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.11.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “2N” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-39170-08-18-2022, me objekt “Rikonstruksion i shkollës ‘Muhamet Shehu’ dhe ndërtim i palestrës” me fond limit 81,153,183.83 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.09.2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ASI-2A CO” SHPK & 2 Z Konstruksion” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit

Ankimues:

“2 N” SHPK
Lagjja “Paskuqan fushë”, Rruga “Demokracia” Pallati nr. 2, Kati i Parë, Paskuqan

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ASI-2A CO” SHPK & 2 Z Konstruksion” SHPK
Rruga “Skënderbeu”, Lagjja Bishanake, Pll.nr.18, Hyrja Nr.6, Fier

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Patos
Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*".

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*".

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.08.2022, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-39170-08-18-2022, me objekt “Rikonstruksion i shkollës ‘Muhamet Shehu’ dhe ndërtim i palestrës” me fond limit 81,153,183.83 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.09.2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.2. Në datë 06.09.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në datën 04.10.2022, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

1. BOE “ASI-2A CO” SHPK & 2 Z Konstruksion” SHPK	68,210,930.91 lekë	skualifikuar
2. “2 N” SHPK	69,974,257.00 lekë	skualifikuar
3. “Shendelli” SHPK	71,986,105.00 lekë	kualifikuar
4. “ED Konstruksion” SHPK	78,717,408.73 lekë	kualifikuar
5. “Glavenica” SHPK	79,803,656.25 lekë	skualifikuar
6. “Viante Konstruksion” SHPK	80,337,128.70 lekë	skualifikuar

II.4. Më datë 04.10.2022 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave dhe nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike ka njoftuar operatorin ekonomik “2 N” SHPK për arsyen e skualifikimit të ofertës së tij si më poshtë vijojnë:

“Oferta juaj skualifikohet pasi nga verifikimi rezulton se ne formularin e ofertes, oferta totale pa TVSh eshte 69,974,257 leke pa TVSh , kurse vlere e ofertes se deklaruar ne preventivin e ofertes eshte 69,976,257.33 leke pa TVSh. Gjithashtu pas verifikimit te preventivit te ofertes ku jane analizuar te gjitha zerat e punimeve qe do te kryhen rezulton qe nuk ka gabime artimetike , si ne formularin e ofertes (ne tabelen permbledhese dhe ne vleren e deklaruar me shifra dhe fjale ,ashtu dhe ne preventivin e zerave te punimeve) ,vlere kjo referuese dhe thelbesore per klasifikimin dhe renditjen e operatoreve ne proceduren e prokurimit publik. Për sa me siper Oferta juaj refuzohet pasi ka mosperputhje midis vleres se deklaruar ne formularin e ofertes dhe vleres te deklaruar ne preventivin e ofertes. Bazuar ne piken 1 te nenit 92 LPP me nr.162 date 23/12/2021 ku percaktohet se “Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.”

II.5. Në datën 21.10.2022 është kryer publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II.6. Në datën 26.10.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 2345 prot., e operatorit ekonomik “2 N” SHPK duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2345/2 prot., datë 26.10.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “2 N” SHPK nga procedura e prokurimit objekt-ankimi. Nga informacioni i autoritetit kontraktor rezulton, se operatori ekonomik ankimues “2 N” SHPK ka dorëzuar ankesën në autoritet kontraktor me datë 27.10.2022.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr.2686/4 prot., datë 02.11.2022, protokolluar me tonën nr. 2345/3 prot., datë 04.11.2022, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe vendimin lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues me argumentin “[...] KSHA vëren se:

Bazuar ne piken 3 te nenit 82 te VKM-se me Nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” citohet si me poshte:

Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.

b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.

Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

-shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 290 e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar,

-shuma absolute e të gjitha korigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.

Per sa me siper shoqeria "2N" nuk ka gabime aritmetike qe Komisioni i Vleresimit te Ofertave ti drejtohej me nje kerkese per korigjim te gabimeve aritmetike por ka mosperputhje midis vleres se deklaruar ne formularin e ofertes dhe vleres te deklaruar ne preventivin e ofertes. Pra ne formularin e ofertes vlera pa TVSh eshte 69,974,257 leke pa TVSh , kurse vlera e ofertes se deklaruar ne preventivin e ofertes eshte 69,976,257. 33 leke pa TVSh dhe oferta e tij refuzohet automatikisht.

Gjithashtu, bazuar ne nenin 92 te LPP me nr.162 date 23/12/2021, pika 1,,ku percaktohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. "Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme" si dhe pika 2 ku percaktohet se Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

Pra siç percaktohet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, Autoriteti Kontraktor ka për detyrë të korigjojë vetëm gabimet aritmetike të zbuluara gjatë korigjimit, të ofertave (çka nuk jemi në kushtet e gabimeve aritmetike), por nuk është i lejuar të kërkojë asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerën e saj apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Gjithashtu, po ti referohemi dhe Vendimit të Komisionit te Prokurimit Publik me Nr.K.P.P.621/2019 ne faqen 240 arsyeton se:

Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se, si në formularin e ofertës, ashtu edhe në preventivin e ofertës, ku janë përshkruar dhe analizuar të gjithë zërat e punëve që do të kryhen për këtë procedurë prokurimi, vlera e ofertës pa tatimin mbi vlerën e shtuar, është në shumën 1.776.111.282, vlerë kjo e deklaruar edhe në formularin e ofertës me shifra dhe fjalë. Në këtë kontekst, oferta totale e ofruar pa tatimin mbi vlerën e shtuar është në vlerë të njëjtë dhe pa gabime aritmetike, si në formularin e ofertës (në tabelën përmbledhëse dhe në vlerën e deklaruar me shifra dhe fjalë), ashtu edhe në preventivin e zërave të punimeve, vlerë kjo referuese dhe thelbësore për klasifikimin ' dhe renditjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik pasi çdo ofertues duhet të shënojë në preventiv çmimet për çdo z punimi dhe çmimin në total të ofertës të të gjitha punëve pa TVSH në respektim kjo të legjislacionit në fuqi.

Nga arsyetimi si me siper rezulton se oferta totale e ofruar pa tatimin mbi vlerën e shtuar nga operatori ekonomik "2N" nuk eshte në vlerë të njëjtë, si në formularin e ofertës (në tabelën përmbledhëse dhe në vlerën e deklaruar me shifra dhe fjalë), ashtu edhe në preventivin e zërave të punimeve, vlerë kjo referuese dhe thelbësore për klasifikimin dhe renditjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, pasi çdo ofertues duhet të shënojë në preventiv çmimet për çdo zë punimi dhe çmimin total të ofertës të të gjitha punëve, pa TVSH, ne respektim

kjo te legjislacionit ne fuqi dhe se oferta juaj nuk permban gabime aritmetike sipas legjislacionit te prokurimit ne fuqi qe KVO-ja tu drejtohej me kerkese per korrigjim te gabimeve aritmetike por refuzohet oferta automatikisht bazuar ne piken 1 te nenit 92 LPP me nr.162 date 23/12/2021 ku percaktohet se "Pa cenuar dispozitat e parashikuara ne kete ligj, nuk duhet te kerkohet, te ofrohet ose te lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vleshme". Për sa më sipër pretendimet e OE ankimes se oferta permban gabime aritmetike nuk qëndrojnë dhe skualifikimi nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave eshte i drejte. Përfundimisht, ju bëjmë me dije se ankesa e shoqërisë "2N" SHPK Tirane për procedurën me objekt "Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Shehu dhe ndertim i palestres" nuk pranohet dhe se s'kualifikimi nga KVO -ja eshte i drejte dhe i bazuar ne legjislacionin, e prokurimit publik."

II.9. Në datën 27.10.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëherazi pranë autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër ankimi elektronik A/2022/2640 dhe nr. 2369 prot., e bashkimit të operatorëve ekonomikë (në vijim BOE) "ASI-2A CO" SHPK & 2 Z Konstruksion" SHPK, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tyre nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.10. Me datë 28.10.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik BOE "ASI-2A CO" SHPK & 2 Z Konstruksion" SHPK ka paraqitur të njëjtën ankesë me nr.2369/3 prot., datë 28.10.2022.

II.11. BOE "ASI-2A CO" SHPK & 2 Z Konstruksion" SHPK rezulton i skualifikuar për arsyet si më poshtë:

"Ju skualifikoheni pasi: Bazuar ne marreveshjen e bashkepunimit midis operatoreve dhe ne formularin e ofertes ekonomike ku eshte bere ndarja e zerave ne preventiv kane deklaruar se : Operatori "2 Z" merr persiper te kryej punime prishje, murature, suvatimi dhe veshje, dyer dhe dritare

- 1- sipas pikes 2.3.5 te kriteret e vecanta te kualifikimit per punime murature ju nuk plotesoni numrin e punonjesve per ndertimin e ketij zeri punimi, pra ju nuk keni asnje murator te deklaruar*
- 2- Sipas pikes 2.3.5 tek kriteret e vecanta te kualifikimit per punime suvatimi ju nuk dispononi asnje suvatues per kryerjen e ketij zeri punimi, po ashtu sipas pikes 2.3.7 ju nuk dispononi pajisjen perkatese "Pompe suvatimi" sipas kriterëve te percaktuara ne DST.*
- 3- Sipas pikes 2.3.5 te kriteret e vecanta te kualifikimit per punime prishje ju nuk plotesoni numrin e punonjesve qe nevojiten per kryerjen e ketij zeri punimi, sipas formularit ju deklaroni vetem 2 punetor te thjeshte.*

Operatori "ASI-2A CO" merr persiper te kryejë pjesen tjeter te punimeve si: punime ndertimi, sistemimi i jashtëm.

1- Sipas pikes 2.3.7 te kriteret e vecanta te kualifikimit mungoni mjete tip "Miniekskavator" i cili sherben per kryerjen e punimeve te marra persiper."

II.12. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2369/2 prot., datë 27.10.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të BOE “ASI-2A CO” SHPK & “2 Z Konstruksion” SHPK nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.13. Nëpërmjet shkresës me nr.2685/6 prot., datë 02.11.2022, protokolluar me tonën nr. 2369/3 prot., datë 04.11.2022, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe vendimin lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e BOE ankimues me argumentin: “[...]KSHA vëren se:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ASI-2ACO” ShPK në bashkëpunim me “2Z Konstruksion” ShPK Fier janë krijuar me marreveshjen e bashkëpunimit dhe bazuar në nenin 88 pika 3 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, cilesohet si me poshte:

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për sa më sipër bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit midis operatorëve në formularin e ofertës ku është bërë ndarja e zërave në preventiv dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në pikën B “Deklaratë mbi disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontratë, operatori “2 Z Konstruksion” ShPK merr përsipër të kryejë punime prishje/çmontimi, murature, suvatimi, tarrace, shtresa, dyer/dritare dhe bojatisje. Per kryerjen e punimeve të muratures dhe suvatimit, bazuar edhe në pikën 2.3.5 në DST për punonjesit e specializuar nevojiten 2 punonjes muratore/suvatues, nderkohe qe ASI-2A nuk disponon asnje te tille, si dhe bazuar ne piken 2.3.7 ju nuk disponon asnje pajisje tip “Pompe suvatimi” nga 2 te tilla te kerkuara ne DST.

Ne analogji te argumentimit te mesiper, operatori “ASI-2A CO” ka marr persiper gjithe punimet e prishjes cmontimit te godines se shkolles dhe bazuar ne volumet e parashikuara ne preventiv, per kryerjen e ketyre punimeve nevojiten minimalisht 8 punetore te thjeshte, nderkohe qe ju dispononi vetem 2 te tille, cka nuk ploteson numrin e punonjesve te kerkuar ne piken 2.3.5 të DST.

Gjithashtu, operatori “ASI-2A CO” ShPK ka marre persiper te kryeje gjithe punimet e sistemimit te jashtem te territorit te shkolles, perfshire edhe ndertimin palestres, punime te cilat kane volume te konsiderueshme germimi dherash per kryerjen e te cilave nevojitet nder mjetet e

kerkuara edhe mjete tip minieskavator, te cilin ASI-2A CO nuk e disponon, duke mos plotesuar piken 2.3.7 te kriterëve e vecanta te kualifikimit.

K.SH.A. vëren se pretendimet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “ASI-2ACO” ShPK në bashkëpunim me “2Z Konstruksion” ShPK. Fier nuk qëndrojnë pasi kapacitetet e vetdeklaruar të secilit pjesëtar të Bashkimit të Operatorëve Ekonomik nuk plotësojnë kriteret e kërkuara për kualifikim dhe të nevojshme për realizimin e kontratës dhe si rrjedhojë e këtyre mangësive ankesa nuk pranohet.

Përfundimisht, ju bëjmë me dije se ankesa e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “ASI-2A CO” ShPK në bashkëpunim me “2Z Konstruksion” ShPK Fier për objektin e prokurimit “Rikonstruksioni i shkolles “Muhamet Shehu” dhe ndertim i palestres, nuk pranohet dhe se skualifikimi është bere pasi nuk permbushen kerkesat per kualifikim.”

II.14. Nga shqyrtimi i materialeve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, pranë Komisionit të Prokurimit Publik në formë shkresore dhe as në sistem elektronik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE ankimues “ASI-2A CO” SHPK & “2 Z Konstruksion” SHPK nga procedura e prokurimit me arsyen se: *“Operatori “2 Z” merr përsipër të kryejë punime prishje, murature, suvatimi dhe veshje, dyer dhe dritare “1-sipas pikes 2.3.5 te kriteret e vecanta te kualifikimit per punime murature ju nuk plotesoni numrin e punonjesve per ndertimin e ketij zeri punimi, pra ju nuk keni asnje murator te deklaruar; 2-Sipas pikes 2.3.5 tek kriteret e vecanta te kualifikimit per punime suvatimi ju nuk dispononi asnje suvatues per kryerjen e ketij zeri punimi, po ashtu sipas pikes 2.3.7 ju nuk dispononi pajisjen perkatese “Pompe suvatimi” sipas kriterëve te percaktuara ne DST.”* KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.5 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. **Teknike ndertimi 2 (dy)** per kete duhet te paraqese Diplome te shkolles se mesme, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente), dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Qershor 2022 e ne vazhdim
- b. **Karpentier 3 (tre)** per kete duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente), dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Qershor 2022 e ne vazhdim.

- c. **Hekurkthyes 2 (dy)** per kete duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente), dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise Qershor 2022 e ne vazhdim.
- d. **Saldator 2 (dy)** per kete duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente), dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise Qershor 2022 e ne vazhdim.
- e. **Muratore/Suvatues 2 (dy)** per kete duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente), dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise Qershor 2022 e ne vazhdim.
- f. **Puntore te thjeshte 15 (pesembedhjet)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise Qershor 2022 e ne vazhdim.
- g. **Hidraulike 1 (nje)** per kete duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente), dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga Qershor 2022 e ne vazhdim.
- h. **Bojaxhinje 2 (dy)** per kete duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente), dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise Qershor 2022 e ne vazhdim.
- a. **Shofere 2 (dy)** per kete duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme leje drejtimi, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente), dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Qershor 2022 e ne vazhdim, (Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes do te jene te kontraktuar nuk kerkohet te figurojne ne listpagesat e shoqerise).
- b. **Manovratore 2(dy)** per kete duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme , leje drejtimi, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente), dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Qershor 2022 e ne vazhdim, (Ne raste kur makinerit disponohen me qira, keta punonjes do te jene te kontraktuar nuk kerkohet te figurojne ne listpagesat e shoqerise).

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- diplome,
- kontrata pune,
- deshmi kualifikimi
- Ne raste kur makineritë disponohen me qira, keta punonjes do te jene te kontraktuar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

III.1.2. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.7 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes deri (18-ton) cope 2 (dy)
- Kamionçinë deri ne 3 ton cope 2 (dy)
- Mini ekskavator cope 1 (nje)
- Ekskavator me goma cope 1(nje)

• Kamion me vinc/ Autovinc	cope	1(nje)
• Betoniere	cope	1 (nje)
• Vibrator betoni	cope	2(dy)
• Autobot uji	cope	1(nje)
• Depozite uji 5'000 litra	cope	1 (nje)
• Matrapik	cope	2 (dy)
• Gjenerator 3.5kWA	cope	1 (nje)
• Skela metalike	m2	1000
• Betoforma/ Armature	m2	100
• Pompe suvatimi	cope	2 (dy)

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qira, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit te paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qiradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet te cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
- fatura tatimore të blerjes ose dokumente zhdoganimi të mjetit.

Pranohet marrja me qira e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qiramarrjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

III.1.3. Në përmbushje të kriterëve më sipër BOE ankimes ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- *Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “2 Z Konstruksion” SHPK*
- *Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “ASI-2A CO” SHPK*

III.1.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të

njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve¹ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

5. *Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

6. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. *Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”*

III.1.6. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor

² Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.8. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër BOE ankimes ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik "ASI-2A CO" SHPK dhe "2 Z Konstruksion" SHPK, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton, se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 05.09.2022 të nënshkruar mes shoqërisë "ASI-2A CO" SHPK dhe shoqërisë "2 Z Konstruksion" SHPK përkatësisht në nenin 3 "*Përqindja e pjesëmarrjes dhe fitimit*" rezulton, se ndarja e përqindjeve është: "*1. Shoqëria "ASI-2A CO" SHPK 54.86 % të pjesëmarrjes dhe fitimit; 2. Shoqëria "2Z Konstruksion" SHPK 45.14% të pjesëmarrjes dhe fitimit.*" Akoma më tej, referuar listës së çmimeve sipas zërave të preventivit rezulton, se zërat punime murature dhe punime suvatimi dhe veshje do të realizohen nga operatori ekonomik "2 Z Konstruksion" SHPK. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij duke gjykuar, se në interpretim të nenit 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, jemi përballë rastit ku autoriteti kontraktor kriteret e përcaktuara i konsideron si kusht për përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe këto të fundit, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik të dokumenteve standarde të tenderit "*Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar Muratore/Suvatues 2 (dy)*

per kete duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme, Dëshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente), dhe te figuroje ne listpagesen e shoqerise Qershor 2022 e ne vazhdim”, operatori ekonomik “2 Z Konstruksion” SHPK në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar në SPE në Pjesën III: Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit, Seksioni B: Deklarata “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt-kontrate” nuk deklaroi se disponon punonjës murator apo suvatues për përmbushjen e kriterit në fjalë. Gjithashtu, në përmbushje të kriterit 2.3.7 të kapacitetit teknik operatori ekonomik “2 Z Konstruksion” SHPK në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar në SPE në Pjesën III: Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit, Seksioni C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt-kontrate” nuk deklaroi se disponon mjetin pompë suvatimi për realizimin e punës në përputhje me zerat e punimeve që ka marrë përsipër të kryejë. Komisioni gjykon, se kërkesat në fjalë janë pjesë e kapacitetit teknik, referuar kjo dokumenteve standarde të tenderit, dhe nga ku bazuar në nenin 88 pika 3 të të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kërkesat teknike në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “2 Z Konstruksion” SHPK nuk ka paraqitur në sistem në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në seksionin përkatës *Pjesa III: Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit, Seksioni B: Deklarata “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt-kontrate” dhe seksionin Pjesën III: Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit, Seksioni C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”* punonjësve të specializuar murator apo suvatues për realizimin e zerave përkatës që ka marrë përsipër të kryejë si dhe nuk ka paraqitur asnjë deklaram që disponon pompë suvatimi, pasi për natyrën e punëve që do kryejë duhet të ketë në dispozicion një pajisje të tillë. Pretendimet e BOE ankimes se duke qenë se kanë marrë pjesë si bashkim operatorësh kjo i bën kompanitë që të funksionojnë si një e vetme dhe ku i gjithë stafi dhe makineritë e pajisjet e kompanive do të jenë të përfshirë për kryerjen e punimeve, nuk qëndron, pasi në interpretim të nenit 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se sipas zerave që ka marrë përsipër të realizojë operatori ekonomik

“2 Z konstruksion” SHPK, mungesa e deklaramit e punonjësve të specializimit murator ose suvatues, si dhe mjeti pompë suvatimi në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell edhe mospërmbushjen e kritereve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.5 dhe 2.3.7 të kapacitetit teknik.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “2 Z Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë nuk konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të skualifikimit, KPP gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, pasi operatori ekonomik “2 Z Konstruksion” SHPK si pjesë e bashkimit të operatorëve referuar zërave që do të realizojë nuk e përmbush kriteret e mësipërme të kualifikimit, gjendja faktike e juridike e BOE ankimues pas arsytimit të mësipërm të KPP-së do të vazhdojë të mbetet e skualifikuar, e për rrjedhojë ato nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “2 N” SHPK për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsytimin se: *“Oferta juaj skualifikohet pasi nga verifikimi rezulton, se në formularin e ofertës, oferta totale pa TVSh është 69,974,257 leke pa TVSh, kurse vlera e ofertës së deklaruar në preventivin e ofertës është 69,976,257.33 leke pa TVSh....”* KPP vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 1 të dokumenteve të tenderit, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

(b) Ne [vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti], nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit].

(c) Ne ofrojmë të realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

(d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Vlerësimit;
4. Kriteret e Përzgjedhjes;
5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
6. Preventivin e çmimeve
7. Termat e referencës (nëse është rasti)
8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	

Vula	
-------------	--

III.3.2. Në shtojcën 2 të dokumenteve të tenderit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

Oferta ekonomike e detajuar

Nr.	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Çmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentet e tenderit)

III.3.3. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “2 N” SHPK rezulton se, për plotësimin e kërkesës së autoritetit për listën e çmimeve sipas zërave nga ana e këtij operatori është ofruar si vijon:

SHUMA I+II	58,498,519
FONDI REZERVE 5 %	2,924,926
SHUMA TOTALE	61,423,445
TVSH 20 %	12,284,689
TOTALI ME TVSH	73,708,134

.....

III SHUMA PAJISJE (A+B+C+D)	8,552,812
------------------------------	-----------

III.3.4. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të

njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.3.5. Në nenin 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave”, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Pas afatit përfundimtar për hapjen e ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohet që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.

3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.3.6. Në nenin 82 pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se: “3. *Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:*

- a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.*
- b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.*
- c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.”*

III.3.7. Sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se referuar “*Listës së çmimeve sipas zërave të preventivit*”, të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “2 N” SHPK, rezulton, se vlera e ofertuar është 69 976 267 lekë pa TVSH nga ku përlllogaritja e së cilës del nga vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e pajisjeve. Ndërkohë që në formularin e ofertës sipas shojcës 1 të DST çmimi total i ofertës pa TVSH është deklaruar 69 974 257 lekë pa TVSH. Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nuk ndodhemi para gabimeve aritmetike në kuptim të nenit 82 pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nga ku nëse do të ishim përballë një fakti të tillë, autoritetit kontraktor i lind detyrimi që të kryejë veprimet procedurale gjatë konstatimit të këtij gabimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi në rast të konstatimeve të tilla. Komisioni gjykon, se në këtë rast kemi mospërputhje mes vlerës së ofertuar nga operatori ekonomik në listën e çmimeve sipas zërave të preventivit dhe vlerës së ofertës të paraqitur në formularin e ofertës sipas shojcës 1 të DST. Komisioni vëren, se në vetvete ka një llogaritje të qartë e të ndarë të secilit prej zërave të preventivit të përcaktuar në dokumentet e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, duke mos cenuar dhe shkeluar as bazën ligjore në fuqi për sa i përket hartimit të preventivit, vlera totale e të cilit është 69 976 267 lekë pa TVSH, e cila është përlllogaritur nga vlera e punimeve të kërkuara pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e pajisjeve, por kjo vlerë nuk është e njëjtë me vlerën e deklaruar në formularin e ofertës me shifra dhe me fjalë. Argumenti i dhënë nga ankimesi se vlera e deklaruar pa TVSH në formularin e ofertës ka një diferencë me vlerën pa TVSH të deklaruar në preventivin e punimeve me 2.000 lekë diferencë, duke e

konsideruar si një gabim aritmetik për të cilin pretendonte se autoriteti kontraktor duhet të paraqiste kërkesë pranë operatorit ekonomik për rregullimin e tij, nuk ka mbështetje ligjore, pasi nuk ndodhemi në asnjë prej rasteve të përcaktuara në nenin 82, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lidhur me gabimet aritmetike të ofertës. Në këtë kuadër, duke qenë se nuk jemi në kushtet e nenit 82 pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, oferta nuk mund të korrigjohet pa prekur përmbajtjen e saj, veprim ky i cili bie në kundërshtim me nenin 92 pika 3 paragrafi i dytë të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Është barrë e operatorit ekonomik ankimues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekti-shqyrtimi, të paraqesë informacion dhe dokumentacion të saktë dhe të vërtetë se i plotëson të gjitha kërkesat dhe kushtet e parashikuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e *lex specialis* për prokurimin publik. Për më tepër, si kusht për shpalljen fitues, një ofertuesi nuk duhet t’i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën si në rastin konkret.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “2 N” SHPK, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e BOE ankimues “ASI-2A CO” SHPK & “2 Z Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-39170-08-18-2022, me objekt “Rikonstruksion i shkollës ‘Muhamet Shehu’ dhe ndërtim i palestrës” me fond limit

81,153,183.83 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.09.2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “2 N” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga BOE ankimes “ASI-2A CO” SHPK & “2 Z Konstruksion” SHPK si dhe operatori ekonomik “2 N” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri

